

KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Në Tiranë sot më datë 23 / 03 2021, lidhet kjo kontratë dhurimi kuotash ("Kontrata") nëpërmjet palëve si më poshtë:

PALA DHURUESE:

Myrvete Xhaja - shtetase shqiptar, lindur më 03.09.1940 në Lepenicë, identifikuar me nr. personal E05903070N, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar (këtu e më poshtë quajtur "*Dhuruesi*")

PALA PRANUESE E DHURIMIT:

Arjana Fullani – e bija e Bajram dhe Myrvete, shtetase shqiptare, lindur më 03.09.1965 në Tiranë, identifikuar me nr. Personal G55903098G, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar (këtu e më poshtë quajtur "*Pranuesi i dhurimit*")


PREAMBULA

- A. Dhuruesi është ortak në shoqërinë "GP Medical AL" shpk. me nr. NIPT: L82023006C, me seli në Tiranë, Vorë Rr. Nacionale e vjetër, Nr. 41, (në vijim referuar si "**Shoqëria**"), dhe zotërues I një pjesëmarrjeje prej 10 % të kapitalit të Shoqërisë, e përbërë nga 1 kuote, me vlerë kapitali 10,00 Lekë.
- B. Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë Pranuesit të Dhurimit, i cili është dakord, të gjitha kuotat e tij në shoqërinë lart përmendur me vlerë kapitali 10,00 Lekë, sipas kushteve të kësaj kontrate.

Në këto kushte, në bazë të nenit 761 të Kodit Civil dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 - OBJEKTI I DHURIMIT

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është dhurimi pa asnjë kusht dhe kalimi në favor të Pranuesit të Dhurimit i gjithë kuotave që disponon me vlerë kapitali 10,00 Lekë, të zotëruara nga dhuruesi në kapitalin e Shoqërisë, që përfaqësojnë 10% të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie, nga dhuruesi tek pranues i dhurimit.
- 1.2 Pas dhurimit të kuotave sipas përcaktimeve të këtij neni, ndarja e kuotave mes ortakëve të Shoqërisë është si më poshtë vijon:



- 
1. Ljuben Petrushevski, zotërues i numrit të kuotave me vlerë kapitali 50,00, dhe përqindje pjesëmarrje – 50 %.
 2. Edvin Liço, zotërues i numrit të kuotave me vlerë kapitali 40,00, dhe përqindje pjesëmarrje – 40 %.
 3. Arjana Fullani, zotëruese e numrit të kuotave me vlerë kapitali 10,00, dhe përqindje pjesëmarrje – 10 %.

Neni 2 - TRANSFERIMI I PRONËSISË

Pala dhuruese ndërmjet kësaj kontrate i dhuron përfituesit të gjitha këto kuota dhe zhvishet nga e drejta e pronësisë mbi to, nisur nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontratë. Përfitues i dhurimit bëhet pronar dhe zotërues më të drejta të plota të kuotave të dhuruara, sipas përcaktimit të nenit 1 më sipër.

Neni 3 - DISPOZITA TË NDRYSHME


- 3.1 Kjo kontratë dhurimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe përbën gjithë marrëveshjen mes Palëve lidhur me objektin e saj.
- 3.2 Palët bien dakord që kjo kontratë dhurimi do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë kontratë dhurimi do të zbatohen parashikimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi dhurimin.
- 3.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për të gjykuar mosmarrëveshjet që Palët nuk mund t'i zgjidhin me mirëkuptim ndërmjet tyre.
- 3.4 Kjo kontratë dhurimi regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)

Kjo Kontratë Dhurimi hartohet dhe nënshkruhet nga Palët në 4 kopje me vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe.

PALËT KONTAKUESE:

Dhuruesi:

Myrvete Xhaja



Pranuesi i dhurimit:

Arjana Fullani

